

Institucion mikrokreditor, **Kreditimi Rural i Kosovës LLC** me seli në Prishtinë, me qëllim furnizimi me material informatik shpall këtë:

FTESE PER PARAQITJEN E OFERTES

Me anën e kësaj ftese, ftojmë kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën për furnizim me materialin informatikë siç vijon:

- 1. Kompjuter desktop 26 copë**, me karakteristika minimale Procesor Core i5 4M Cache / RAM 8 GB / HDD 500 GB / DVD-RW, tastierë (english) dhe mouse. Në rast se kompania posedon kompjuterë me karakteristika te ndryshme është e preferueshme që të bëhet ofertë e veçantë për secilin lloj të kompjuterëve (i5, i7..etj). Kompjuterët duhet të jenë Brand Name.
- 2. Monitor 19” (wide screen) 26 copë**,
- 3. Laptop 2 copë**, me karakteristika minimale Procesor Core i5 4M Cache / RAM 8 GB / HDD 500 GB / DVD-RW, tastierë (english). Në rast se kompania posedon laptop me karakteristika te ndryshme është e preferueshme që të bëhet ofertë e veçantë për secilin lloj (i5, i7..etj).
- 4. Operating System Windows 10 Pro, 28 copë**,
- 5. Makina fotokopjuese** (skaner/printer/fotokopje) 2copë karakteristikat minimale: A4, (për orientim, modele që kanë madhësi dhe karakteristika të ngjashme me Canon MF411dw)
- 6. Fotoaparati digjital 2 copë** dhe Sd card 4 GB (minimum 12 mega pixel, Optical zoom 20x, me bateri te integruar),
- 7. Printer All in one** (skaner/printer/fotokopje) 3 copë – karakteristikat minimale: A4, 18 ppm.
- 8. Printer 1 copë** – karakteristikat minimale: A4, 18 ppm.
- 9. Wireless mobile printer 1 copë**, - karakteristikat minimale: A4, 8 ppm.
- 10. Projektor, 1 copë**,
- 11. Mikrotik** me switch modul 2 copë, me karakteristika minimale: CPU 1GHz, RAM 2GB, minimum 8 porte.
- 12. Invertor 3 copë** (Tripp lite / APSX 1250 apo te ngjashëm),
- 13. Bateri minimum 12V / 200 Ah, 5 copë**,
- 14. UPS, 26 copë**.

Në ofertë përveç tjerash duhet të specifikohet: afati i liferimit, afati i garancionit dhe servisimi.

Çmimet e ofertuara duhet të jenë me TVSH.

Zgjedhja e ofertës më të volitshme do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertës më të volitshme duke u bazuar në kualitetin, çmimin, garancionin e ofruar dhe servisimin.

Afati i paraqitjes së ofertave **deri me 23.02.2018.**

Ofertat mund të dërgohen përmes adresës: krk_imf@krk-ks.com apo direkt në zyrën e KRK, **Rruga Behije Dashi Nr.4 (afër stacionit të policisë nr.2), Prishtinë.**